



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-007

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M., më datë 17.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M..

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme më 19 qershor 2024, përmes Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, është pranuar ankesën disiplinore e palës N.H., ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M..

Pala ankuese, në ankesën e tij ka paraqitur pretendimet e tij, se gjyqtari V.M., nën ndikimin e avokatit O.C., ka marrë aktvendim me të cilin ka refuzuar kërkesën e tij në çështjen juridike kontestimore duke pretenduar se me një veprim të tillë ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare. Në ankesën e tij, pala thotë se ka paraqitur disa herë kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit V.M., nga lënda C.nr.2321/23, mirëpo këto kërkesa janë refuzuar nga Kryetari i Gjykatës. Tutje, në ankesën e tij, i njëjti pretendon se gjyqtari është dashur t'ia dërgoj vendimin lidhur me çështjen e tij në kohë, por që i njëjti më datë 24.05.2024 merr aktvendim dhe e dënon me gjobë, duke u thirrur në atë se gjoja ka ofenduar gjykatën, një gjë të tillë pala pretendon se është keqpërdorim i pastër, duke shtuar se gjyqtari ka pasur interes me avokatin O.C., *“duke bërë hajgare me ligje siç e ka zakon Gjykata Themelore në Pejë, të bëjë pazare me lëndë”*. Parashtruesi i ankesës, thotë se për një parregullsi të tillë ka paditur gjyqtarin dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës për kompensim dëmi, dhe se kërkon se nga ky i fundit suspendimin e gjyqtarit për performancë të dobët dhe për keqpërdorim detyre.

Me qëllim të vërtetimit të këtyre pretendimeve, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka analizuar shkresat e lëndës si dhe deklaratën lidhur me këtë rast të dhënë nga gjyqtari V.M..

Në deklaratën e tij, gjyqtari M., theksoi se paraqitësi në ankesë nuk ka treguar se cilat shkelje disiplinore kanë konsumuar veprimet e tij, duke shtuar se parashtruesi i ankesës ka paraqitur disa herë kërkesa për përjashtimin e tij mirëpo për këtë kërkesë është vendosur po ashtu edhe nga Kryetari i Gjykatës së Apelit i cili e ka refuzuar si të pabazuar. Kërkesa për përjashtimin

është përcjellë edhe tek Gjykata Supreme e cila me akt përcjellës e ka kthyer me arsyetimin se kërkesa e tillë është e përsëritur dhe se është vendosur njëherë. Po ashtu në deklaratë theksohet fakti se ndaj palës ankuese më datë 29.04.24 është shqiptuar gjobë në lartësi prej 500 euro për shkak se ka fyer rëndë gjykatën. Për një gjë të tillë, pala ankuese ka përsëritur kërkesën për përjashtim, me arsyetimin se ndaj tij si gjyqtar ka paraqitur padi. Tutje, gjyqtari në deklaratën e tij ka thënë se ai ka marr vendime si gjyqtar i çështjes në kuadër të kompetencave të tij ligjore, vendime të cilat mund të apelohe.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së gjyqtarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës si dhe nga të gjitha pretendimet e palës ankuese, rezulton se kemi të bëjmë me shprehje të pakënaqësisë rreth vendimeve të marra gjatë procedurës, nga ana e gjyqtarit të çështjes. Në këtë drejtim, si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes së gjyqtarëve dhe vendimit të marrë nga gjyqtari i çështjes, ngase gjyqtarët por edhe Kryetari i Gjykatës janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre respektivisht në punën e tyre.

Bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtar“*, në rastin konkret konsideroj se veprimet e gjyqtarit në raport me lëndën konkrete nuk përbëjnë bazë për dyshim për ndonjë sjellje të mundshme disiplinore .

Duke u bazuar në këto, kryetari i Gjykatës Supreme vlerëson se një ankesë e tillë në bazë të këtyre pretendimeve është e pabazuar, dhe se veprimet e gjyqtarit nuk konsumojnë asnjë shkelje disiplinore të paraparë me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.